

# INDEKSI I HARMONIZUAR I ÇMIMEVE TË KONSUMIT


Gusht 2026

Inflacioni i matur me Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK) në muajin Gusht 2026 është 3,0 %.

Kontributin kryesor në rritjen vjetore të çmimeve në muajin Gusht e dha grupi "Ushqime dhe pije joalkoolike" me +0,74 pikë përqindje, me një rritje vjetore me 2,1 %, pasuar nga grupi "Transporti" me një kontribut prej +0,59 pikë përqindje dhe rritje vjetore prej 7,0 %. "Argëtim, sport dhe kulturë", me një kontribut prej +0,55 pikë përqindje dhe një rritje vjetore 8,5 %, "Restorante dhe shërbime akomodimi" me një kontribut prej +0,51 pikë përqindje dhe një rritje vjetore 3,5 %, "Pije alkoolike dhe duhan" me një kontribut prej +0,19 pikë përqindje dhe një rritje vjetore me 3,6 %, "Shërbimi arsimor" me një kontribut prej +0,15 pikë përqindje dhe një rritje vjetore 3,3 %, "Shëndeti" me një kontribut prej +0,11 pikë përqindje dhe një rritje vjetore 2,1 %, etj.


Në Gusht 2026, çmimet e konsumit u ulën me 0,1 %, krahasuar me muajin e mëparshëm. Ulja mujore u ndikua kryesisht nga ulja e çmimeve të grupeve "Ushqime dhe pije joalkoolike" dhe "Veshje dhe këpucë" me 0,9 % secili, pasuar nga grupet "Pije alkoolike dhe duhan" me 0,4 %, "Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë" me 0,2 %. Nga ana tjetër, çmimet e grupit "Transporti" shënuan një rritje me 2,1 %, pasuar nga grupet "Restorante dhe shërbime akomodimi" me 0,3 %, "Qira, ujë, energji elektrike, gaz dhe karburante të tjera" dhe "Shëndeti" me 0,1 % secili.

**FIG. 1 NDRYSHIMI VJETOR I IHÇK SIPAS SHTETEVE, GUSHT 2026<sup>1</sup>**



<sup>1</sup> INSTAT publikon indekset e pa rumbullakosura, ndërsa EUROSTAT publikon indekset të rumbullakosura me dy shifra dhjetore. Kjo mund të shkaktojë ndryshime midis tyre, për shkak të metodës së ndryshme të rumbullakimit të përdorur nga secili institucion.

FIG. 2 NDIKIMI I GRUPEVE NË NDRYSHIMIN VJETOR




TAB. 1 NDRYSHIMET NË PËRQINDJE MATUR NGA INDEKSI I HARMONIZUAR I ÇMIMEVE TË KONSUMIT

| Kodi            | Grupet                                                               | Peshat       | Gusht 2026 <sup>2</sup> | 08-26/Viti 2025 | 08-26/08-25 | 08-26/07-26 |
|-----------------|----------------------------------------------------------------------|--------------|-------------------------|-----------------|-------------|-------------|
| <b>Gjithsej</b> |                                                                      | <b>100,0</b> | <b>102,8</b>            | <b>2,8</b>      | <b>3,0</b>  | <b>-0,1</b> |
| 01.             | Ushqime dhe pije joalkolike                                          | 344,6        | 101,1                   | 1,1             | 2,1         | -0,9        |
| 02.             | Pije alkolike dhe duhan                                              | 51,9         | 104,0                   | 4,0             | 3,6         | -0,4        |
| 03.             | Veshje dhe këpucë                                                    | 36,9         | 97,4                    | -2,6            | -2,0        | -0,9        |
| 04.             | Qira, ujë, energji elektrike, gaz dhe karburante të tjera            | 57,9         | 101,6                   | 1,6             | 1,6         | 0,1         |
| 05.             | Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë                  | 56,5         | 101,4                   | 1,4             | 1,2         | -0,2        |
| 06.             | Shëndeti                                                             | 53,5         | 102,2                   | 2,2             | 2,1         | 0,1         |
| 07.             | Transporti                                                           | 82,7         | 106,8                   | 6,8             | 7,0         | 2,1         |
| 08.             | Informacioni dhe komunikimi                                          | 24,5         | 99,2                    | -0,8            | -1,0        | 0,0         |
| 09.             | Argëtim, sport dhe kulturë                                           | 63,9         | 110,9                   | 10,9            | 8,5         | 0,0         |
| 10.             | Shërbimi arsimor                                                     | 46,1         | 102,6                   | 2,6             | 3,3         | 0,0         |
| 11.             | Restorante dhe shërbime akomodimi                                    | 144,5        | 103,9                   | 3,9             | 3,5         | 0,3         |
| 12.             | Sigurime dhe shërbime financiare                                     | 6,6          | 103,1                   | 3,1             | 3,3         | 0,0         |
| 13.             | Kujdesi personal, mbrojtja sociale dhe mallra e shërbime të ndryshme | 30,5         | 103,4                   | 3,4             | 3,2         | 0,0         |

<sup>2</sup> 2025=100

FIG. 3 NDRYSHIMET VJETORE DHE MUJORE TË IHÇK

**Shënim për përdoruesit:**

- Të dhënat e detajuara mujore dhe vjetore sipas grupeve janë të disponueshme në databazën statistikore të INSTAT: [Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit](#)
- Në zbatim të Politikës së Trajtimit të Gabimeve, INSTAT ndërmerr pa vonesë korrigjimin e çdo gabimi të identifikuar në statistikat zyrtare të publikuara. Përdoruesit informohen në mënyrë të menjëhershme dhe transparente për korrigjimet dhe ndryshimet e reflektuara, në përputhje me parimet e paanshmërisë, transparencës dhe cilësisë së statistikave zyrtare. Politika e plotë e Trajtimit të Gabimeve është e disponueshme në adresën: <https://www.instat.gov.al/media/9577/politika-e-trajtimit-te-gabimeve.pdf>

# Metodologjia

Duke filluar me publikimin e të dhënave për muajin Gusht 2026, vihet në dispozicion seria e plotë kohore e Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (HICP) për periudhën 2016–2025, sipas ECOICOP 2018 (ECOICOP ver. 2). Gjatë përgatitjes së serisë kohore, disa produkte janë riklasifikuar në nivelet e detajuara. Në përputhje me kërkesat e Eurostat-it, indeksi i përgjithshëm i HICP-së për çdo muaj mbetet i njëjtë deri në shifrën e dytë dhjetore. Për rrjedhojë, normat historike të inflacionit të përgjithshëm mbeten të pandryshuara.

## Ndryshime metodologjike

Duke filluar nga Shkurt 2026, Indeksi i Çmimeve të Konsumit përlogaritet sipas klasifikimit ECOICOP 2018. Kalimi në klasifikimin e ri përfshin ristrukturimin e artikujve të shportës, riklasifikimin e disa produkteve. Struktura e ECOICOP ver. 2 përbëhet nga 13 divizione kryesore, të detajuara më tej në grupe, klasa dhe nënklasa. Implementimi i këtij klasifikimi është në përputhje me Rregulloren (BE) 2024/3159, duke siguruar harmonizimin e plotë me praktikatat statistikore evropiane dhe ndërkombëtare.

Periudha e referencës së indeksit është ndryshuar nga Dhjetor 2020 = 100 në 2025 = 100.

Gjithashtu, në muajin Janar si çdo viti Indeksi i Çmimeve të Konsumit shoqërohet me disa ndryshime metodologjike sipas metodologjisë ndërkombëtare të llogaritjes së këtij treguesi, të cilat konsistojnë në:

- Përditësimin e peshave: Peshat e mallrave dhe shërbimeve janë ndryshuar duke u bazuar në të dhënat e Llogarive Kombëtare-Shpenzimet Monetare të Konsumit Final të Familjeve.
- Përditësimin e listës së mallrave dhe shërbimeve: Shporta përbëhet nga **410** produkte dhe shërbime.
- Përditësimin e listës së njësive tregtare ku mblidhen çmimet.

## Përkufizime

Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) mat ndryshimin e nivelit të çmimeve me pakicë të mallrave dhe shërbimeve nga pikëpamja e strukturës së shpenzimeve të cilat konsumatori (vendas dhe i huaj) synojnë për konsumin final në territorin e Shqipërisë. IHÇK përdoret për monitorimin e lëvizjes së çmimeve me pakicë në vendet Evropiane, duke krahasuar përqindjen e inflacionit ndërmjet vendeve të Evropës dhe si inflacion zyrtar i Bankës Qendrore Evropiane duke siguruar stabilitetin e çmimeve në Bashkimin Ekonomik dhe Monetar.

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve ndërmjet muajit korent me të njëjtin muaj të vitit të mëparshëm. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve korente në nivelin e çmimeve, por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të cilitdo muaj.

Ndryshimi mujor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të muajit korent me muajin e mëparshëm. Ky tregues është i ndjeshëm nga efektet sezonale.

Ndryshimi mesatar 12 mujor mat ndryshimin e indeksit mesatar të konsumit në 12 muajt e fundit me indeksin mesatar të 12 muajve të mëparshëm.

## Krahasimi midis IÇK-së dhe IHÇK-së

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) dhe Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) janë hartuar për të matur ndryshimin e nivelit mesatar të çmimeve të paguara për konsumin e mallrave dhe shërbimeve nga të gjithë familjet private, kolektive dhe shpenzimet e turistëve në Shqipëri. IÇK dhe IHÇK përdoren si matës të inflacionit të konsumit.

### Ngjashmëritë midis IÇK dhe IHÇK

- *Qëllimi*

IÇK dhe IHÇK matin ndryshimin në nivelin mesatar të çmimeve të një shporte fikse mallrash dhe shërbimesh të konsumit.

- *Sistemi i klasifikimit*

IÇK dhe IHÇK përdorin të njëjtin klasifikim të mallrave dhe shërbimeve - Klasifikimi Evropian i Konsumit Individual sipas Qëllimit (ECOICOP Versioni 2)

- *Shpenzimet dhe burimi i të dhënave të shpenzimeve*

Përfshihen vetëm shpenzimet brenda territorit të Shqipërisë. Burimi kryesor i të dhënave për shpenzimet ("peshat") është Anketa e Buxhetit të Familjeve dhe Llogaritë Kombëtare "Shpenzimet Monetare të Konsumit Final të Familjeve.

- *Të dhënat e çmimeve*

IÇK dhe IHÇK llogariten bazuar në çmimet e mbledhura në të njëjtat njësi tregtare, përdorin të njëjtën klasifikim të produkteve dhe ndajnë të njëjtën metodologji të hartimit të indeksit.

- *Periodha referuese (bazë) t*

IÇK dhe IHÇK llogariten duke pasur si periudh referuese të indeksit vitin 2025 (2025=100)

- *Metodologjia*

IÇK dhe IHÇK ndjekin metodologjinë e përcaktuar në Rregulloren e Komisionit Evropian (KE), Nr 2016/792, mbi IHÇK, për hartimin dhe grumbullimin e komponentëve të indekseve të çmimeve, e cila është zhvilluar nga Eurostat (Zyra e Statistikave e BE-së) në bashkëpunim me Institutet Statistike Kombëtare të vendeve anëtare të BE-së.

### Dallimet ndërmjet IÇK dhe IHÇK

- *Matës të inflacionit të Çmimeve të Konsumit*

- IÇK është matësi zyrtar i inflacionit në Shqipëri

- IHÇK përdoret për monitorimin e lëvizjes së çmimeve me pakicë në vendet Evropiane, duke krahasuar përqindjen e inflacionit ndërmjet vendeve.
- *Mbulimi i produkteve*
  - IÇK përmban 411 artikuj
  - IHÇK përmban 410 artikuj
- *Mbulimi dhe burimi i të dhënave për shpenzimet (peshat)*
  - Në IÇK mbulohen vetëm shpenzimet e familjeve private shqiptare të kryera brenda dhe jashtë territorit të vendit.
  - IHÇK mbulon të gjitha shpenzimet e bëra brenda territorit të vendit nga familjet shqiptare, përfshirë familjet private, kolektive dhe shpenzimet e turistëve në Shqipëri.
- *Peshat*
  - Në IÇK peshat janë shprehur në për 100
  - Në IHÇK peshat janë shprehur në për 1000

| Kodi | Grupet                                                               | Peshat     |              |
|------|----------------------------------------------------------------------|------------|--------------|
|      |                                                                      | IÇK        | IHÇK         |
|      | <b>Gjithsej</b>                                                      | <b>100</b> | <b>100,0</b> |
| 01.  | Ushqime dhe pije joalkolike                                          | 34,1       | 344,6        |
| 02.  | Pije alkolike dhe duhan                                              | 5,0        | 51,9         |
| 03.  | Veshje dhe këpucë                                                    | 3,8        | 36,9         |
| 04.  | Qira, ujë, energji elektrike, gaz dhe karburante të tjera            | 20,2       | 57,9         |
| 05.  | Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë                  | 7,0        | 56,5         |
| 06.  | Shëndeti                                                             | 3,2        | 53,5         |
| 07.  | Transporti                                                           | 6,4        | 82,7         |
| 08.  | Informacioni dhe komunikimi                                          | 3,6        | 24,5         |
| 09.  | Argëtim, sport dhe kulturë                                           | 2,0        | 63,9         |
| 10.  | Shërbimi arsimor                                                     | 3,0        | 46,1         |
| 11.  | Restorante dhe shërbime akomodimi                                    | 5,7        | 144,5        |
| 12.  | Sigurime dhe shërbime financiare                                     | 1,5        | 6,6          |
| 13.  | Kujdesi personal, mbrojtja sociale dhe mallra e shërbime të ndryshme | 4,5        | 30,5         |